



KONFERENCA MBI PËRGATITJEN PËR VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE PËR KOSOVËN

## KOORDINATORËT KOMUNAL DHE ATA MINISTROR VLERËSOJNË PËRMBUSHJEN E STANDARDEVE PËR KOSOVËN

Asociacioni i Komunave të Kosovës me mbështetjen e KFOS-it ka organizuar konferencën mes Koordinatorëve për Standarde të Komunave të Kosovës dhe atyre të Ministrive të Qeverisë së Kosovës për të përgatitur një "vlerësim paraprak" të pozitës aktuale të komunave në lidhje me agjendën e "Standardeve për Kosovën".

Në Konferencë morën pjesë 29 përfaqësues të Komunave të cilët kryejnë rolin e Koordinatorëve Komunal për Standarde si dhe kanë marrë pjesë dy koordinator të ministrive të qeverisë së Kosovës për standardet.

Konferencën e ka hapur drejtori ekzekutiv i përcaktuar i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Sazan Ibrahim i cili paraqiti pikat kryesore që janë përcaktuar të debatohen, ndërsa fjalën hyrëse e ka paraqitur ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së dhe kryetari i Prishtinës z.Ismet Beqiri.

Në hapje të takimit, ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri tha se "njëra ndër sfidat kryesore jo vetëm të komunave të Kosovës në muajt vijues është edhe tema që po bisedojmë sot, përmbushja dhe vlerësimi i standardeve për Kosovën e cila përmbushje e plotë e këtyre standardeve është si një kusht për vetë neve". Kryetari Beqiri shtoi se "barra kryesore mbi përmbushjen e standardeve do të bie mbi pushtetin lokal i cili praktikisht do të bëjë edhe implementimin e tyre. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se në mungesë të disa kompetencave që i kanë komunat do të kufizohet edhe implementimi i një pjese të vogël të standardeve për Kosovën". Sipas z.Beqiri "vlerësimi se as këthimi nuk mund të bëhet pa një zhvillim lokal se edhe statusi politik ndërsa sandardet për Kosovën janë rrugë drejt të statusit të shtetit të Kosovës". "Standardet më shumë janë nevojë për ne e jo kushte ndërsa vetëm me përmbushjen e tyre dhe si e tillë Kosova e meriton hyrjen në Bashkimin Evropian". Ndërsa në fjalën e tij z.Lutfi Haziri - Ministër i Pushtetit Lokal i cili mori pjesë në Konferencë, tha se "do të punojë së bashku me kryetarët e komunave në mënyrë që çdo qytetar i Kosovës të jetojë në pronën e vet e kjo arrihet me përmbushjen e standardeve. Qeveria e re e Kosovës nuk e pranon dinamikën e deritashme të zbatimit të standardeve në përmbushjen e tyre. Dinamika e tashme parashihet zbatim të plotë të standardeve dhe kjo duhet ndodhur në secilën hallkë të tyre. Obligim i intituacioneve të Kosovës është për me krijuar një ambient të qëndrueshëm, për të siguruar pronën e qytetarëve, për të krijuar kushte për jetë më të mirë si dhe drejtësi



dhe të drejta për të gjithë. Gjashtë muaj të përcaktuar për përmbushjen e standardeve nëpër komuna është një kohë shumë e ngushtë". Ministri Haziri në vazhdim duke folur për disa pika të standardeve që nuk mund të plotësohen nga komunat për shkak të mungesës së kompetencave si në gjykatat komunale shtoi se "nuk mundet komuna dhe organet komunale me ditë kush është krimimnel e kush duhet me u kthye e kush jo". Ndërsa në fund të fjalës së tij z.Haziri duke përgëzuar AKK për këtë konferencë tha se "uroj që AKK të jetë shtëpia e komunave për me arrit me i përmbush të gjitha

obligimet dhe përgjegjësitë e tyre". Përfaqësuesi komunal i Vitisë, koordinatori për standarde z. Jakup Jahiri tha se "ne jemi për zbatimin e standardeve dhe Kosova synon realizimin e tyre në të gjitha segmentet mirëpo duhet tua bëjmë me dije se pse kërkojnë përgjegjësi ata që nuk votojnë në Kosovë. Koordinatori për standardet e Kosovës në Ministrinë e Shërbimeve Publike z.Daut Krasniqi tha se "ne jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin me komunat e Kosovës. Ato na kanë sjellur shumë informacione në përgatitjet për përmbushjen e standardeve. Tek standardi 'Sundimi i ligjit' ne në MShP kemi vlerësuar 26 pika kryesore dhe 88 të tjera në detale të cilat duhet të plotësohen në muajt vijues. Tani jemi në fazën e plotësimit të standardeve që i kemi vlerësuar këtyre ditëve ku disa nga standardet janë të plotësuar në shkallën 30 për qind, disa 60 për qind e disa janë të përmbushura madje edhe 90 për qind. Poashtu duhet të ceket që në standardin Sundimi i ligjit shumica e pikave kryesore janë tërësisht pjesë të rezervuara të pjesës ndërkombëtare në Kosovë".

vijon në fq. 2

Pas formimit të Qeverisë së Kosovës, ndërime edhe në kreun e AKK-së

### Ismet Beqiri - u.d. i kryetarit të AKK-së

Me rastin e zgjedhjes së kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Lutfi Haziri në postin e Ministrit të Pushtetit Lokal dhe pas dorëheqjes nga posti i kryetarit të komunës së Gjilanit, z.Haziri ditë më parë ka dhënë dorëheqje edhe nga posti i kryetarit të AKK-së. Në një takim përshëndetës që ka organizuar AKK-ja me kryetarët e komunave të Kosovës është përshëndetur puna dhe angazhimi i deritashëm i z.Lutfi Haziri. Ndërsa ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së është vendosur që të jetë kryetari i komunës së Prishtinës z.Ismet Beqiri i cili është edhe anëtar i Bordit të AKK-së. Kryetari Beqiri falenderoi kryetarët e komunave për përgjegjësinë dhe besimin që ia kanë dhënë për të drejtuar Asociacionin e Komunave të Kosovës në periudhën e ardhshme.



Një projekt i përbashkët i MEF-it, AER-it dhe AKK-së

## Përgaditet projekti i sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm të financave publike

Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Agjencia Evropiane për Rindërtim në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës po realizojnë një projekt për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Auditimit të Brendshëm, që ndikon në administrimin më të mirë të burimeve dhe në realizimin e programeve. "Ky projekt synon plotësimin e sistemit të menaxhimit financiar me sistemin e kontrollit të financave publike dhe auditimit të brendshëm, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal", tha ministri i Ekonomisë dhe Financave Ali Sadriu, në seminarin e organizuar me kryetarët e Kuvendeve Komunale.

Zyrtarja e AER-it, projekt-drejtuesja Nadia Konstantini, tha se ky projekt ka filluar në janar të këtij viti dhe do të përfundojë në janar të vitit 2005. Projekti përbëhet nga dy

komponente: zhvillimi i kontrollit të brendshëm të financave publike dhe zhvillimi i auditimit të brendshëm, të cilat janë të ndërvarura dhe zhvillohen paralelisht. Konstantini tha se ka përfunduar faza e parë të trajnimit, i cili ka përfshirë audituesit e ministrive por edhe të komunave. "Ne kemi përfunduar një dokument politikash, që do të transferohet në një plan veprues apo plan aksionesh që është çështje thelbësore. Ndërsa qëllimi i këtij programi që do të përmbushet për secilën komunë, do të jetë kryesisht për sqarimin apo elaborimin e kontrollit të financave publike dhe në esencë çfarë përmban në anën praktike dhe të realizimit" - tha ajo. Ndërsa, duke folur në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimimi tha se standardet e kontabilitetit për sektorin publik dhe rregulloret për financat publike, duhet të

jenë në harmoni me standardet ndërkombëtare. "Duhet të ekzistojë gjurmë e rregullt e auditimit që mundëson vërtetimin e rrjedhës së gjithmbarshme të fondeve, që nga burimi e deri te caku i fundit. Duhet përfshihet procedura kompetente për kontrollin e zotimeve dhe pagesave përfshirë këtu edhe vëmendjen e duhur për futjen në përdorim të aspektit të pavarur të transaksionit" - tha z.Ibrahimimi.

Sipas Ibrahimimit, Asociacioni i Komunave në bashkëpunim me "projektin për zhvillimin dhe fuqizimin e auditimit të brendshëm dhe sistemit e menaxhimit dhe kontrollit financiar, në të ardhmen do të organizojë takime pune me kryetarët e komunave si dhe me shërbyes civilë, ku do të elaborohen roli i auditimit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm financiar.

KONFERENCA MBI PËRGATITJEN PËR VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE PËR KOSOVËN

## KOORDINATORËT KOMUNAL DHE ATA MINISTROR VLERËSOJNË PËRMBUSHJEN E STANDARDEVE PËR KOSOVËN



vijon nga faqja e parë

z.Sherif Kurteshi - koordinator komunal për standarde në KK të Gjilanit tha se "i kemi operacionalizuar punët për standardet dhe kemi hartuar një dokument komunal të sundimi i ligjit ku neve na dalin 142 detyra vetëm në komunën e Gjilanit. Ai shtoi se "në vecanti ne duhet të publikojmë praktikën e mira të realizimit të standardeve në mënyrë që edhe të jemi shembull dhe udhërrëfyes për të tjerët".

Koordinatorja për Standarde e Ministrisë për Tregti dhe Industri znj.Fitore Jusufi - tha se "standardi i tretë dhe i katërt janë cilësuar si standardet determinante, shumë të ndieshme, standarde që kërkojnë përkushtim, përkrahje politike dhe standarde që kushtëzohen edhe nga minoritetet". Ajo shtroi çështjen "Si më funksionalizuar komunën në realizimin e standardeve meqë komuna është bazamenti i përbashkës" si dhe ceku mundësinë e hulumtimit të një strategjie të ashtuquajtur "transporti publik i integruar". Znj.Jusufi në vazhdim potencoi se "në stra-

tejinë e komunave për kthime është punuar me pyetësinë i cili ishte pak i vonuar por ka qenë imperativ i kohës për me pasur një pasqyrë se sa kanë arritur komunat në përbushjen e standardeve". "Emërtimet poashtu janë të rëndësishme, në shumë komuna ose nuk ka emërtime ose nuk respektohet dygjuhësia. Edhe aty ku ska asnjë minoritet dygjuhësia është e obliguar. Koordinatorja e MTI-së për standardet tha se "Komunat duhet ta kenë strategjinë për kthime, zyrtar për kthime dhe zyrtar për mbrojtjen e komuniteteve". Drejtori Ekzekutiv i Përcaktuar i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi tha se "krahas strategjisë së implementimit duhet të ketë edhe implementim si të bëhet ai dhe sa kushton, pra duhet përllogaritur kostonë e Standardeve". Sipas tij, "te standardi i kthimit, kostoja e këtij standardi është i madh dhe duhet të definohet kush i mbulon këto shpenzime". Zëvendëskryetarja e komunës së Kamenicës znj. Nexhmije Kallaba tha se "vendosja e tabelave hyrëse në komuna nuk është përgjegjësi e autoriteteve lokale, andaj duhet të ndahen punët cilat janë përgjegjësi e komunave e cilat janë të institucioneve të përkohshme vetqeverisëse të Kosovës në përmushjen dhe implementimin e standardeve. Poashtu Institucionet e Përkohshme Vetqeverisëse duhet sa më parë të bëjnë një model për përpilimin e strategjisë së realizimit të standardeve ndërsa komunat duhet të formojnë një Komisioni për hartimin e një drafti për strategjinë e standardeve në mënyrë që ai të jetë i njëjtë për të gjitha komunat.

### KONKLUZIONET

**Takimi i Koordinatorëve për Standarde ka nxjerr 11 konkluzione.**

- Statusi përfundimtar i Kosovës nuk mund të jetë peng i përbushjes së Standardeve
- Pjesa më e madhe e Standardit të parë, pra Funksionimi i Institucioneve Demokratike është përbushur
- Tek Standardi i dytë, Sundimi i ligjit, ka mungesë të infrastrukturë ligjore dhe se pjesa më e madhe e nënstandardeve është kompetencë e UNMIK-ut
- Kërkohet bartje e kompetencave të Institucionet vendore
- Komunat në standardin e dytë kanë më shumë rol këshillëdhënës ndaj qytetarëve lidhur me bashkëpunimin me organet e rendit dhe ato gjyqësore
- Standardet III, IV dhe IV (liria e lëvizjes, Kthimi dhe Riintegrimi dhe Ekonomia) janë cilësuar si standardet më të rëndësishme
- Plotësimi i këtyre standardeve varet edhe nga gatishmëria e palës serbe
- Nevojitet buxhet shtesë në përbushjen e standardeve
- Kërkohet eliminimi i strukturave paralele të cilat në një mënyrë pengojnë përbushjen e standardeve
- Komunat janë duke punuar me përkushtim në përbushjen e Standardeve
- Kërkohet ndihmë më e madhe nga Institucionet Qendrore

## Konferencë e suksesshme e Asociacionit të Komunave të Kosovës



Pas hapjes së Konferencës së Tretë Vjetore të AKK-së, kryeparlamentari z.Nexhat Daci tha se "harmonia mes tërësisë dhe pjesëve të saj është e barabartë me progresin dhe mirëqenien e qytetarëve. Komuna është njësi themelore shumë e rëndësishme vetëqeverisëse, komuna është vendi ku zbatohet pushteti dhe ku realizohet lloji dhe karakteri i qeverisjes dhe vendi ku qytetarët janë apo nuk janë të kënaqur me shërbimet që ofrohen dhe me kompetencat që autoritetet lokale i kanë".

Kryetari i AKK-së z.Lutfi Haziri tha se "roli i AKK mbetet i njëjti si në themelimin e tij në vitin 2001 - të përdorë parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe t'i aplikojë ato për zhvillimin e komunave të Kosovës". Duke folur për temën e Konferencës, dialogu i nivelit lokal me atë qendror z.Haziri shtoi se "ne jemi ftuar të marrim pjesë në disa grupe punuese në ministri të ndryshme. Në kuadër të strukturës së AKK-së ne duhet të jemi më të përgatitur për t'ju përgjigjur kërkesave të qeverisë kur ato na prezantohen. Për një dialog të fortë mes këtyre dy niveleve nevojitet gatishmëri nga ana e qeverisë për të punuar me ne" - përfundoi në fjalën e tij z.Haziri.

Në hapje të debatit me kryeparlamentarin Daci, kryetari Haziri falenderoi Dacin për mundësitë që u ka dhënë komunave për pjesëmarrje në komisionet e Parlamentit të Kosovës gjatë mandatit të kaluar.

Në mesazhet përshëndetëse për AKK z.Francesko Bastali (UNMIK) tha se "AKK-ja është esenciale për zhvillimin e shoqërisë civile e cila do të jetë në gjendje që të bashkëveproj me qeverinë lokale dhe të marrë pjesë në të gjitha aspektet e vendimmarrje". Z.Odran Hayes (AER) tha se "AKK-ja është bërë një bazë e fortë dhe ky fakt demonstron rëndësinë e AKK-së dhe mundësinë për ti dhënë formë strukturave të ardhshme në Kosovë". Znj.Christine Roth (UNDP) shtoi se "bashkëpunimi i UNDP-së me AKK-në tregon përkushtimin që kanë të dy organizatat për të kuptuar jetën e përditshme të qytetarëve por edhe të atyre që të cilët janë përgjegjës për ta udhëhequr jetën e tyre".

Z.Ken Yamashita (USAID) ka thënë se "unë ju sfidoj të gjithë juve që të punoni dhe ta bëni AKK-në një aktor kryesor në Kosovë dhe e sfidoj

Në kuadër të programit studimor të Fondacionit Konrad Adenauer

### Kryetarët e disa komunave të Kosovës qëndruan në Gjermani

Kryetarët e komunës së Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Podujevës dhe Fushë Kosovës kanë qëndruar për një vizitë një javore në Gjermani. "Programi në të cilin kanë marrë pjesë ishte i organizuar nga Fondacioni gjerman Konrad Adenauer dhe është Program studimor dhe informativ për kryetarët e komunave të Kosovës".

Kryetarët e komunave gjatë dy ditëve e para pos vizitës që i bëjnë Dresdenit, të dielën ishin mysafirë të Kryeministrit të Landit të Saksionisë ku ishte prezent edhe një deputet i Bundestagut Gjerman, ndërkaq që gjatë darkës u takuan me z. Gunther Portune, anëtar i Parlamentit të Republikës dhe sekretar shtetëror për arsim. Kryetarët e komunave të Kosovës kanë vizituar një ndërmarje për prodhimin e orëve ku u takuan edhe me z. Markus Drebler, kryetar i komunës të atij qyteti të vogël gjerman. Gjatë orëve të pasditës delegacioni kosovar u takua në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës në Landin e Saksionisë, z. Portune. Biseda u zhvillua rreth çështjeve aktuale, reformat në arsim, sport, kulturë, etj.



AKK-në që të jetë edhe më e fortë në të ardhmen dhe një forcë relevante në bisedimet me qeverinë qendrore për të definuar dhe përforcuar rolin e qeverive lokale". Z.Owen Masters (KE) është shprehur se "i kam pa zhvillimet e AKK-së dhe kjo është një nga arritjet e mëdha të Kosovës, arritje për njerëzit e Kosovës, çka është më e rëndësishme nga pikëpamja ime është një arritje për qeverisjen lokale në Kosovë". Z.Paskal Fiesku (OSBE) tha se "posaqërisht AKK-ja është një faktor kyç gjatë diskutimeve në muajt e ardhshëm në lidhje me reformat e vetëqeverisjes lokale". Z.Alan Packer (IFES Ltd.) tha se "Asociacioni i Komunave të Kosovës - njësoj si asociacionet në mbarë Evropën - ka një rol kritik për të luajtur në bashkimin e mendimeve të komunave dhe për të avokuar pozitën e tyre në qeverinë qendrore të atyre të cilët janë përgjegjës për ta udhëhequr jetën e tyre". Nërsa zëvendëskryetari i Asociacionit të Njësisive të Vetëqeverisjes Lokale (ANJVL) të Maqedonisë z.Imer Selmani shtoi se "'shfaq një ndjenjë kënaqësie t'i drejtohet këtij tubimi dhe kësaj Konferencë. Ne si dy Asociacione që veprojmë në vende fqinje si Maqedonia dhe Kosova kemi shumëçka të përbashkëta dhe me siguri qëllimet tona të përbashkëta janë që një ditë të jemi pjesë përbërëse e BE-së".

Duke folur në temën Studim Rasti për marrëdhëniet mes nivelit qendror dhe atij lokal znj/Ruth Coleman nga Byroja Ndërkombëtare e Qeverisjes Lokale - Kryetarja e komunës North Wiltshire në Britani të Madhe tha se "në Byronë Ndërkombëtare të Qeverisë Lokale (LGIB) ndihemi krenarë që jemi pjesë e këtij konsorciumi të përbërë nga IFES dhe të tjerë, që po punon me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) për të ndihmuar në zhvillimin e demokracisë lokale dhe për të ndërtuar kapacitetin e AKK-së për të ndihmuar vetë komunat për të ofruar qeverisje të mirë dhe shërbime për komunitetet lokale". Ndërsa drejtori Ekzekutiv i Byrosë Ndërkombëtare të Qeverisjes Lokale (LGIB) z.Mike Ashley është shprehur se "i kam ndjekur zhvillimet e projektit me AKK-në, që nga themelimi i konsorciumit me IFES-in dhe partnerë të tjerë, deri te përgatitja e propozimit të projektit dhe dërgimit pranë Agjencisë Evropiane për Rindërtim, dhe më në fund fitimin e kontratës dhe fillimin e punës këtuj". Ditën e dytë të Konferencës së Tretë Vjetore të Asociacionit të Komunave të Kosovës e ka hapur dhe udhëhequr anëtar i Bordit të AKK-së z.Ismet Beqiri dhe kryetar i komunës së Prishtinës i cili njoftoi të pranishmit me punimet e ditës së dytë të Konferencës.

vijon në fq. 4



## Konferencë e suksesshme e Asociacionit të Komunave të Kosovës



vijon nga fq. 3

Në kuadër të prezentimit të Raportit të Punës së AKK-së për vitin 2004, kryetari i Asociacionit të Komunave z.Lutfi Haziri tha se "me kënaqësi të madhe ju prezentoj Raportin e Asociacionit të Komunave të Kosovës për periudhën 2003/2004. Gjatë kësaj periudhe ka pasur zhvillime të rëndësishme në Kosovë. Poashtu kryetari Haziri tha se "raporti Vjetor i punës së AKK-së paraqet temat kryesore të aktiviteteve të Asociacionit të Komunave të Kosovës duke përfshirë, aktivitetet ndërkombëtare, lidhjet dhe partnerët e Asociacionit, aktivitetet e AKK-së dhe komunave në lidhje me standardet për Kosovën, projektet për dialogun ndëretnik, angazhimet e Asociacionit rreth pronës komunale, zhvillimi i politikave të qeverisë lokale, reforma administrative dhe zhvillimi ekonomik lokal" - për të cilat ai në vazhdim elaboroi secilën pikë në detaje dhe sqarime të mjaftueshme" - tha ndër të tjera në paraqitjen e raportit vjetor të punës së Asociacionit të Komunave të Kosovës kryetari z.Lutfi Haziri. Pas debatit anëtarët e Kuvendit të AKK-së me shumicë votash kanë miratuar raportin e punës së Asociacionit të Komunave të Kosovës me raportin financiar të vitit 2004. Projektet e ardhshme të AKK-së i ka paraqitur z.Sazan Ibrahim -Drejtor Ekzekutiv (i përcaktuar) i AKK-së. Pas elaborimit të hollësishëm të projekteve për të ardhmen, drejtori i AKK-së z.Sazan Ibrahim tha se këto projekte të prezantuara mund të realizohen vetëm me ndihmën e Komunave të Kosovës dhe me ndihmën e donatorëve të ndryshëm.

e Asociacionit rreth pronës komunale, zhvillimi i politikave të qeverisë lokale, reforma administrative dhe zhvillimi ekonomik lokal" - për të cilat ai në vazhdim elaboroi secilën pikë në

detaje dhe sqarime të mjaftueshme" - tha ndër të tjera në paraqitjen e raportit vjetor të punës së Asociacionit të Komunave të Kosovës kryetari z.Lutfi Haziri. Pas debatit anëtarët e Kuvendit të AKK-së me shumicë votash kanë miratuar raportin e punës së Asociacionit të Komunave të Kosovës me raportin financiar të vitit 2004. Projektet e ardhshme të AKK-së i ka paraqitur z.Sazan Ibrahim -Drejtor Ekzekutiv (i përcaktuar) i AKK-së. Pas elaborimit të hollësishëm të projekteve për të ardhmen, drejtori i AKK-së z.Sazan Ibrahim tha se këto projekte të prezantuara mund të realizohen vetëm me ndihmën e Komunave të Kosovës dhe me ndihmën e donatorëve të ndryshëm.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka përgatitur Deklaratat Parimore me mbështetjen e Grupeve Analizuese Komunale, të cilat punuan gjatë vitit 2004 dhe u pasua nga konsultimet në të gjitha komunat e Kosovës. Prezentimi i Deklaratave Parimore është bërë në tri grupe në seanca të ndara. Grupin e parë (Financa, Arsim dhe Kujdesi Parësor



Shëndetësor) e ka udhëhequr z. Ramdan Gashi - nënkryetar i AKK-së dhe kryetar i komunës së Skënderajit. Grupin e dytë (Vendet Publike, Planifikimi Urban dhe Rural dhe Licencimi) e ka udhëhequr z.Ismet Beqiri - anëtar i Bordit të AKK-së dhe kryetar i komunës së Prishtinës. Grupin e Tretë (Strehimi Social, Rinia dhe Çështjet Gjimore dheTurizmi) e ka udhëhequr z.Muhammed Shabani - anëtar i Këshillit të Kryetarëve të AKK-së dhe kryetar i komunës së Vushtrisë. Gjatë ditës së dytë të Konferencës është mbajtur edhe takimi i Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Kosovës ku kryetarët e komunave plotësuan anëtarët e 11 Komisioneve të AKK-së nga pjesa politike e komunave derisa anëtarët që do të zgjedhen nëpër këto komisione nga pjesa civile e komunave i ka mbetur për obligim Kolegjit të Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave. Kryetarët e Komunave diskutuan dhe miratuan

në parim Projektin e Bankës Botërore që në bashkëpunim të ngushtë me AKK-në do të fillojë një projekt lidhur me regjistrimin e Bisenit. Kjo do të arrihej me reduktimin e barrierave administrative dhe përmirësimin e transparencës dhe përgjegjësisë së shërbimeve rregullative të siguruar nga komunat. Poashtu edhe Kolexhi i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës ka mbajtur takimin e vetë të rradhës. Këtë takim e ka hapur shefi i projektit të IFES Ltd. z.Alan Packer i cili kërkoi nga kryeshefat të prezantojnë eksperiencat e tyre para përfaqësuesve të SOLACE - UDIT në mënyrë që ata të jenë të informuar dhe të bëjnë krahasimin e eksperiencave tuaja me ato të organizatave të lartpërmendura për të mësuar nga eksperiencat në Britani të Madhe. Z.William Saunders në temën "Roli i Kryeshefave Ekzekutivë në Mbretërinë e Bashkuar" theksoi se pozioni i Kryeshefave Ekzekutiv nuk përmendet në Statut. Kryetari i Shërbimit të Paguar është bashkë me Zyrтарin për Financa dhe Zyrтарin për Monitorime, por nuk do të konsiderohen vetëm nëse përmenden gjatë pyetjeve dhe se pavarësisht nga ligji, shumica e Kryetarëve të Shërbimit të Paguar quhen Kryeshefa Ekzekutivë". Në vazhdim z.Beadle James tha se "do të ishte mirë që kur të vij në muajin mars të vitit të ardhshëm zonja Ruth të organizoni një takim të Kolexhit të Kryeshefave me zonjën Ruth në mënyrë që ne ti kemi reagimet e kryeshefave ekzekutiv e veçanërisht të kryeshefave që kanë qenë në Londër për përvojat e fituara nga ajo vizitë". Këtë takim e premtoi z.Mustafë Pllana i cili tha se "ne jemi të gatshëm që këtë delegacion ta presim edhe nëpër vizita nëpër komuna për t'u informuar më afër për mënyrën e punës së kryeshefave ekzekutiv të komunave të Kosovës".

A.Osmani dhe M.Shaqiri



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

### BULETINI

Viti I, Nr. 7 - Nëntor & Dhjetor 2004

Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani, Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi

Rr.Isa Kastrati, Nr.113 Tel&Fax: 038 / 245 - 734  
[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net) komunat\_akk@hotmail.com

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjensioni Evropian për Rindërtim përmes projektit "Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal", implementuar nga IFES Ltd.



Statusin e Vëzhguesit



Anëtar i përhershëm